MARRËVESHJE

NDËRMJET

QEVERISË SË SHTETIT TË IZRAELIT

DHE

QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

PËR

PËRJASHTIMIN E KËRKESËS PËR VIZA PËR MBAJTËSIT E PASAPORTAVE NDËRKOMBËTARE PËR QËLLIME TË TURIZMIT

Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Qeveria e Shtetit të Izraelit (çdoherë të referohet si në vijim "Palët");

Duke dëshiruar të përmirësojnë dhe zhvillojnë më tej marrëdhëniet miqësore që tashmë ekzistojnë midis dy shteteve;

Për të ndihmuar në lehtësimin e procedurave të udhëtimit për mbajtësit e pasaportave ndërkombëtare të dy shteteve, me qëllim promovimin e turizmit midis tyre;

Kanë arritur marrëveshjen e mëposhtme:

Neni 1

Shtetasit e secilit shtet, të cilët janë mbajtës të pasaportave diplomatike dhe zyrtare të vlefshme, do të jenë të përjashtuar në rrethana normale nga obligimi për të marrë një vizë për hyrjen në territorin e shtetit tjetër për një vizitë ose qëndrim të shkurtër për

Neni 6

Kjo Marrëveshje dhe çdo veprim nën të duhet të zbatohen në përputhje me rregullat e legjislacionit vendor, politikat dhe mekanizmat ligjorë në fuqi në Izrael dhe në Kosovë, përkatësisht.

Neni 7

Marrëveshja mund të ndryshohet me miratimin e shkruar të të dyja Palëve. Ndryshimi i tillë do të jetë i vlefshëm sipas procedurave të përmendura në Nenin 9 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 8

Çdo mosmarrëveshje e lindur midis Palëve në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj Marrëveshjeje duhet të zgjidhet përmes negociatave dhe konsultimeve ndërmjet Palëve .

Neni 9

1. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi nëntëdhjetë (90) ditë pas të Njoftimit të dytë të Notës Diplomatike, me të cilat Palët njoftojnë njëra-tjetrën se procedurat ligjore të brendshme për hyrjen në fuqi të Marrëveshjes janë përmbushur.
2.Marrëveshja do të jetë në fuqi për një periudhë prej tre (3) vitesh, dhe Palët do të ekzaminojnë së bashku zbatimin e Marrëveshjes dhe rinovimin e mundshëm për një periudhë të shtuar. Marrëveshja do të rinovohet me shkëmbimin e Notave Diplomatike për periudhat e njëjta.
3. Shkëmbimi i Notave Diplomatike, i përmendur në Nenin 9(2), do të zhvillohet të paktën njëqind e tetëdhjetë (180) ditë para përfundimit të periudhës tre vjeçare. Rinovimi i Marrëveshjes do të hyjë në fuqi në fund të periudhës tre (3) vjeçare.
4. Çdo Palë mund të shkëpusë këtë Marrëveshje në çdo kohë duke dërguar një njoftim shkruar për Palën tjetër përmes kanaleve diplomatike. Në këtë rast, Marrëveshja do të ndërpritet në ditën e (90të) pas datës së njoftimit.

Bërë në..... më ..... dita e ..... 2024, që përkon me ditën _____ të _____ 5784, në Kalendarin Hebraik, në tre tekste origjinale, në gjuhën Shqipe, Hebraike dhe Angleze, të gjitha tekstet janë në të njëjta dhe autentike. Në rast të ndryshimeve në interpretim, teksti në anglisht do të mbizotërojë.

Për Republikën e Kosovës	**Për Shtetin e Izraelit**
SH.S. Znj. Donika Gërvalla-Schwarz	**SH.T. Z. Moshe Arbel**
Zëvendëskryeministre dhe Ministre e Punëve të Jashtme dhe Diasporës	**Ministër i Brendshëm**